



BASHKIA PATOS

Mr. 260 Prof

Patos, 26. 01. 2024

RAPORTI VJETOR I TRANSPARENCËS DHE KONSULTIMEVE PUBLIKE

2023

“E drejta e informimit, si e drejtë themelore e njeriut dhe parim i qeverisjes së mirë”

Informimi Publik

Njoftimi dhe Konsultimi Publik

I. "INFORMIMI PUBLIK"

Informimi është hapi i parë drejt pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen lokale dhe njëkohësisht forcimit të legjitimitetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore. E drejta për informim dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë elementet thelbësore për një qeverisje vendore të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Për garantimin e këtyre të drejtave janë në zbatim dy ligje të rëndësishme, ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe Ligji nr 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" si dhe kuadri ligjor mbi qeverisjen e mirë në nivel vendor.

Pavarësisht zhvillimeve në fushën e transparencës dhe llogaridhënies, zbatimi efektiv i kuadrit përkatës ligjor, kryesisht në nivel vendor ende përbën një sfidë.

Në bazë të Ligjit nr. 119/2014 "Për Të Drejtën e Informimit" **Bashkia Patos** ka caktuar koordinatorin për të Drejtën për Informimit, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoriteti publik. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë si dhe formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe shoqërisë si dhe nxitjen e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Këshilli Bashkiak, ka miratuar me Vendim Nr.83 datë 20.12.2018 "**Programin e Transparencës**", ku në bazë të Ligjit nr. 119/2014 autoritetet publike janë të detyruara të publikojnë informacionin i cili vihet në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Programit të Transparencës synon t'u garantojë qytetarëve të vet të drejtën e lirisë së shprehjes për çështjet vendore, duke vendosur në dispozicion të publikut një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për ti aksesuar ato

Bashkia Patos ka integruar informacionet sipas 7 fushave të Programit të Transparencës. Gjithahstu janë ngarkuar të gjitha informacionet dhe njoftimet zyrtare në faqen kryesore të institucionit.

Faqja zyrtare e Bashkisë Patos, www.bashkiapatos.gov.al, ka qenë duke u përditësuar në vazhdim, duke rritur treguesit e transparencës për qytetarët.

Gjatë vitit 2023, pas kërkesës së Komisionerit të së Drejtës për Informim, janë riparë të gjitha kategoritë që ishin pa plotësuar, të cilat janë ndarë sipas drejtorive të linjës dhe janë përditësuar. Ka ende disa kategori që të cilat duhet të plotësohen dhe përditësohen në vazhdim.

Koordinatori i së Drejtës për Informim ushtrohet nga Specialistja Luizaura Gropa. Të dhënat e saj janë përditësuar në kanalet zyrtare.

Informacioni grumbullohet nga Koordinatorin i të Drejtës për Informim, i cili furnizohet me informacion nga drejtoritë mbi ato dokumenta që janë të detyrueshme për publikim dhe që vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Një nga format e publikimit ka qenë dhe informacioni i ngarkuar në rrjetin social Fb Bashkia Patos, e cila është një faqe e cila përditësohet çdo ditë, si një tregues tjetër i transparencës.

Njoftimet zyrtare janë afishuar në stendën e afishimeve publike dhe në vendet e dukshme në ambiente publike.

Gjatë vitit 2023, janë regjistruar 24 kërkesa për informim, të cilave iu është kthyer përgjigje brenda afatit kohor dhe nuk është regjistruar asnjë ankesë nga kërkuarit ose nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Kërkesat për informacion kanë qenë pa tarifa të aplikuara dhe kryesisht ka qenë informacion i kërkuar me email, e më pak në hard copy.

Ndryshimi në vitin 2023, ka qenë modeli i regjistrimit të kërkesave dhe përgjegjeve, i cili u përditësua dhe gjendet në faqen zyrtare në Programin e Transparencës / Kërkesa për Informim / Regjistri i përditësuar.

II. "KONSULTIMI PUBLIK"

Në zbatim të Ligjit nr 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Bashkia Patos ka caktuar koordinatoren e konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, të projekt dokumenteve strategjike si dhe politikave me interes të lartë publik. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike, si dhe synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të institucionit.

Gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2023, Koordinatorin e Konsultimit Publik dhe Këshilli i Bashkisë kanë bashkërenduar për realizimin e një procesi konsultativ efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Sipas kalendarit vjetor të konsultimeve publike për vitin 2023 me nr. 103 Prot., datë 12.01.2023 si dhe kërkesave të drejtorive janë realizuar 19 dëgjesa publike me banorë të qytetit Patos dhe Njësisive Administrative Zharrëz dhe Ruzhdije.

Procesi i Njoftimit dhe Konsultimit në Bashkinë Patos, gjatë vitit 2023, është bazuar në parimet mëposhme:

1. Transparencë gjatë procesit të njoftimit të konsultimit publik
2. Pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese
3. Efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike
4. Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesura

Procesi i konsultimit është realizuar në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; ligjit nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik" si dhe VKB-së nr. 94 datë 19.12.2022, mbi "Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe Projekt Buxhetit Vjetor për vitin 2023".

Gjatë vitit 2023, Bashkia Patos, për të rritur cilësinë dhe ligjshmërinë e procesit të konsultimit publik, të gjitha seancat konsultimit publik janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Patos, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak në platformën www.konsultimevendore.al, në faqen e dedikuar Bashkisë Patos brenda kësaj platforme (<https://www.konsultimivendor.al/patos/>).

Ky raport vjetor hartohet nga Koordinator i konsultimit publik në Bashkinë Patos, në zbatim të detyrave që përcakton autoriteti publik nën 20 i ligjit 146/ 2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ku sipas parashikimeve të këtij neni organet publike hartojnë dhe publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarjes, ku përfshihet informacion për:

- a) Numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues
- b) Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara
- c) Numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit
- d) Numrin e takimeve publike të organizuara

➤ **Numri i akteve të miratuar nga organi publik përkatës gjatë vitit 2023.**

Këshilli Bashkiak Patos, miratoj gjithsej 85 vendime gjatë vitit 2023¹, të cilat gjenden të publikuara në faqen dedikuar Bashkisë Patos në VENDIME.AL integruar në faqen zyrtare të Bashkisë Patos.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 21 rekomandime konkrete.

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të rrefuzuara:**

Nga 26 rekomandime u mbajtën parashyesh 23 dhe 3 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publik të cilët u angazhuan në organizimin dhe drejtimin e dëgjësive publike.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara²**

1. Dëgjësë publike realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak Patos, datë 10.01.2023, procesverbali nr.3042/2 Prot., me temë **“Diskutimi i Draft rregullore për organizimin dhe funksionimin e varrezave publike në territorin e Bashkisë Patos”**. Në takim morën pjesë: Anëtarë të Këshillit Bashkiak; Kryetarë të fshatrave të Njësisë Ruzhdie, Zharrëz dhe Patos; Përfaqësues të Agjencisë së Shërbimeve publike dhe përfaqësues të subjekteve që kryejnë shërbimin funeral në territorin e bashkisë Patos.

2. Dëgjësë publike realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak Patos datë 15.03.2023, procesverbali nr. 572/3, me temë **“Ngritja e një vendi të përshtatshëm për tregëtimin e produkteve bujqësore, skema mbështetëse AZHBR”**. Në takim morën pjesë: Kryetare e Bashkisë, Anëtarë të Këshillit Bashkiak; Ekspert i bujqësisë z. Ilir Pilku, Kryetarë të fshatrave të Njësisë Ruzhdie, Zharrëz dhe Patos; Fermerë dhe banorë të Bashkisë Patos.

¹ . Vendimet e vitit 2023 mund të shihen në linkun <https://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-patos/>
<https://www.vendime.al/category/patos-vendime-te-keshillit-bashkiak/2023-patos/>

² <https://konsultimivendor.al/patos/>

3. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Njesisë Administrative Zharrëz, salla e mbledhjeve, datë 12.04.2023, procesverbali nr. 806/5, me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024”**. Në takim morën pjesë: Përfaqësues të Drejtorisë së Financës në Bashki, Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të njësinë Administrative Zharrëz.

4. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Njesisë Administrative Ruzhdie, datë 13.04.2023, protokoll nr., 806/6 me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024”**. Në takim morën pjesë: Administrator i Njesisë Ruzhdije, përfaqësues të Drejtorisë së Financës në Bashki, Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të Njesisë Administrative Ruzhdie.

5. Dëgjese publike realizuar në ambientet e TregArt Bashkia Patos, datë 14.04.2023, protokoll nr. 806/7 me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024”**. Në takim morën pjesë: Përfaqësues të Drejtorisë së Financës, Drejtore e Integritimit Europian në bashki, përfaqësues të oganizatës Qendra Europiane dhe të rinj të qytetit Patos, Anëtarë të KVR-së.

6. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos, datë 18.04.2023, protokoll nr. 806/8 me temë **“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024”**. Në takim morën pjesë: Përfaqësues të Drejtorisë së Financës në Bashki, Kryetarë të fshatrave, banorë dhe fermerë të njësinë Administrative Ruzhdie, Zharrëz dhe Patos dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

7. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit të Bashkisë Patos, datë 19.04.2023, protokoll nr. 801/3 me temë **“Vlerësimi i riskut në shkallë vendore”**³. Në takim morën pjesë: Përfaqësues Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Koordinator i projektit Reseal-Undia , Drejtues të ekipit të konsulencës, Drejtor i Departamentit Idra, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, Kryetarë të fshatrave, dhe përfaqësues të Njësive Administrative Zharrëz dhe Ruzhdije.

8. Raport mbi fazën e parë të dëgjesave publike lidhur mbi **“Hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024”**, procesverbal nr. 1129 Prot., datë 25.05.2023.

9. Dëgjese publike realizuar në ambientet e Njesisë Administrative Zharrëz, Salla e mbledhjeve datë 18.07.2023, protokoll nr.1490/1.1 me temë: **“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”**. Në takim morën pjesë : Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit të Bashkisë, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Përfaqësues të Njesisë Administrative, Përfaqësues të Shoqatës ambintaliste “Zharrëz”, Kryetarë të fshatrave, banorë dhe fermerë të Njesisë Administrative Zharrëz.

10. Dëgjese publike realizuar në Njësinë Administrative Ruzhdije, fshati Gjynoqarë, datë 21.07.2023, protokoll nr.1490/1.2 me temë: **Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”**. Në takim morën pjesë: Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit të Bashkisë, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Deputete e

³ <https://konsultimivendor.al/bashkia-patos-njoftim-degjese-publike-me-teme-vleresimi-i-riskut-ne-shkalle-vendore/>

Qarkut Fier, përfaqësues të Njësisë Administrative, kryetarë të fshatrave, banorë dhe fermerë të Njësisë Administrative Ruzhdije.

11. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Sallës së mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Patos, datë 25.07.2023, protokoll nr.1490/1.3 me temë: **“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024”**. Në takim marrëdhënësor pjesë: Kryetari i Bashkisë, Sekretare e Këshillit të Bashkisë, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Deputete e Qarkut Fier, kryetarë të fshatrave, banorë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

12. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Sallës së mbledhjeve të Njësisë Administrative Zharrëz, datë 12.09.2023, protokoll nr.2145/2 me temë: **“Rishikimi i kërkesave Buxhetore për hartimin e PBA-së 2024-2026 dhe konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2024”**⁴. Në takim marrëdhënësor pjesë: Kryetari i Këshillit të Bashkisë, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë fermerë të zonës dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

13. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Njësisë Administrative Ruzhdije, datë 13.09.2023, protokoll nr.2145/3 me temë: **“Rishikimi i kërkesave Buxhetore për hartimin e PBA-së 2024-2026 dhe konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2024”**. Në takim marrëdhënësor pjesë: Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit, Anëtarë të këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë fermerë të zonës dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

14. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Patos, datë 15.09.2023, protokoll nr.2145/4 me temë: **“Rishikimi i kërkesave Buxhetore për hartimin e PBA-së 2024-2026 dhe konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2024”**. Në takim marrëdhënësor pjesë: Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë, fermerë, subjekte të zonës dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

15. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Sallës së mbledhjeve të Njësisë Administrative Zharrëz, datë 24.10.2023, protokoll nr.2511/7 me temë: **“Diskutim i projekt dokumentit të Paketës Fiskale 2024”**⁵. Në takim marrëdhënësor pjesë : Zv. Kryetar i Bashkisë, Kryetari i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë dhe fermerë të zonës.

16. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Administrative Ruzhdije, datë 25.10.2023, protokoll nr.2511/8 me temë: **“Diskutim i projekt dokumentit të Paketës Fiskale 2024”**. Në takim marrëdhënësor pjesë: Zv.Kryetari i Bashkisë, Sekretar i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë dhe fermerë të Njësisë Ruzhdije.

17. Dëgjuesë publike realizuar në ambientet e Sallës së mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Patos, datë 31.10.2023, protokoll nr.2511/9 me temë: **“Diskutim i projekt dokumentit të Paketës Fiskale 2024”**. Në takim marrëdhënësor pjesë: Kryetari i Bashkisë, Kryetar i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë dhe përfaqësues të subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Patos.

⁴ <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.bashkiapatos.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Kalendari-i-komultimeve-per-muajin-shtator-2023.pdf>

⁵ <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.bashkiapatos.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/Kalendari.pdf>

18. Dëgjese publike relizuar në ambientete Sallës së mbledhjeve të Njesisë Administrative Zharrëz, datë 21.11.2023, protokoll nr.2854/4 me temë: “**Prezantim i buxhetit përfundimtar për vitin 2024 dhe projekt buxheti afatmesëm 2024-2026**”⁶. Në takim morrën pjesë: Kryetari i Bashkisë Patos, Kryetari i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë, fermerë të zonës dhe përfaqësues të subjekteve private.

19. Dëgjese publike relizuar në ambientet e Njesisë Administrative Ruzhdije, fshati Gjynoqarë, datë 22.11.2023, protokoll nr. 2854/5 me temë: “**Prezantim i buxhetit përfundimtar për vitin 2024 dhe projekt buxheti afatmesëm 2024-2026**”. Në takim morrën pjesë: Zv. Kryetari i Bashkisë Patos, Kryetari i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, banorë, fermerë të zonës dhe përfaqësues të subjekteve private.

20. Dëgjese publike relizuar në në ambientet e Sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Patos, datë 24.11.2023, protokoll nr.2854/6 me temë: “**Prezantim i buxhetit përfundimtar për vitin 2024 dhe projekt buxheti afatmesëm 2024-2026**”. Në takim morrën pjesë: Kryetari i Bashkisë Patos, Kryetari i Këshillit, Anëtarë të Këshillit Bashkiak, Kryetarë të fshatrave, banorë fermerë të zonës dhe përfaqësues të subjekteve private.

Baza Ligjore:

Në aspektin ligjor për transparencën në nivelin e vetqeverisjes vendore, Shqipëria ka një kornizë ligjore të mirë e cila ka si qëllim garantimin e institucioneve transparente në funksion të qytetarëve, të cilat janë dokumentet themelore që rregullojnë transparencën e institucioneve vendore.

- Kushtetuta,
- Karta Evropiane Për Vetëqeverisjen Vendore,
- Ligji Për Vetëqeverisjen Vendore,
- Ligji Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore,
- Ligji Për Të Drejtën e Informimit,
- Ligji Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

Drejtoresha

Juela Shpata

Koordinatorja për të Drejtën e Informimit

Luizaura Gropa

Koordinatorja e Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

⁶ <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.bashkiapatos.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/kalendar-njoftimi.pdf>